UDHËZIM
Nr.5, datë 19.1.2009

"PËR PROCEDURAT E HAPJES DHE MBYLLJES SË SALLAVE TË LOJËRAVE BASTEVE SPORTIVE, KAZINOVE ELEKTRONIKE, BINGOVE TRADICIONALE"

Në mbështetje të nenit 102/4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe në zbatim të nenit 10 pika 4, germa (dh) të ligjit nr.10033, datë 11.12.2008 "Për lojërat e fatit" Ministri i Financave

UDHËZON:

1.Shoqëritë e lojërave të fatit për kategoritë bingo tradicionale, kazino elektronike, për hapjen e sallave të reja të lojërave të fatit duhet të paraqesin pranë NJMLF-së dokumentacionin e mëposhtëm:

a)Njoftim për hapjen e sallës dhe adresën e saktë të saj.

b)Të dhënat e mëposhtme për personelin e sallës:

b.1.Certifikatë personale të personelit;

b.2.Vërtetim të gjendjes gjyqësore të personelit

b.3.Dëshmi kualifikimi të personelit.

c.Kontratë pune të personelit:

c.1.Garancinë për fituesin e lojës;

c.2.Vërtetimin e pronësisë ose kontratën e qirasë për sallën e re;

c.3.Vërtetim pronësie, deklaratë zhdoganimi dhe certifikatë origjine për pajisjet e përdorura për lojra fati;

c.4.Rregulloret përkatëse për lojërat që do të zhvillohen në këto salla.

2.Shoqëritë e lojërave të fatit, për hapjen e pikave të lojërave të fatit baste sportive duhet të paraqesin në NJMLF dokumentacionin e mëposhtëm:

a)njoftimin për hapjen e pikave dhe aresën e saktë të saj;

b)të dhënat e mëposhtme për personelin e sallës:

b.1.certifikatë personale të personelit;

b.2.vërtetim të gjendjes gjyqësore të personelit;

b.3.dëshmi kualifikimi të personelit;

b.4.kontratë pune të personelit.

c)Vërtetimin e pronësisë së pikave të lojrave të fatit sportive ose kontratën e qirasë.

3.Shoqëritë e lojërave të fatit për mbylljen e sallave të bingove, kazinove elektronike dhe të pikave të lojërave të fatit sportive duhet të paraqesin në NJMLF dokumentacionin e mëposhtëm:

a)Kërkesë për mbylljen e sallës.

b)Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve tatimore.

c)Zgjidhjen e kontratës për ambientet e marra me qira.

4.Shoqëritë që ushtrojnë aktivitet lojëra fati, për transferimin e automateve të miratuara nga sallat ekzistuese në salla të tjera duhet të paraqesin në NJMLF dokumentacionin e mëposhtëm:

a)Kërkesë për transferimin e automateve.

b)Arsyet e transferimit të automateve.

5.Shoqëritë e lojërave të fatit detyrohen të njoftojnë NJMLF-në, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, degën e tatim-taksave të rrethit përkatës, 30 ditë përpara për transferimin, shtimin dhe heqjen e automateve elektronike.

Në rast se shoqëritë e lojërave të fatit nuk paraqesin dokumentacionin e parashikuar në pikat 1, 2 dhe 3 të udhëzimit, nuk mund të ushtrojnë veprimtarinë pa e plotësuar këtë

dokumentacion sipas kërkesave së këtij udhëzimi.

6.Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode